



VENDIM

Nr. 74 Datë 12.10.2009

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS TË
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OSSH SH.A
PËR VITIN 2010**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20, 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.03.2009, Vendimit nr.79, datë 26.06.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 12.10.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e OSSH sh.a për përcaktimin e tarifës të shpërndarjes së energjisë elektrike për OSSH sh.a, për vitin 2010

Vendosi :

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës të shpërndarjes së energjisë elektrike për OSSH sh.a për vitin 2010.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSSH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S
BUJAR NEPRAVISHTA**



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 74 Datë 12 .10.2009

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS TË
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OSSH SH.A
PËR VITIN 2010**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkëlqim Bozgo	_____	_____